

VENDIM
Nr. 132, datë 29.8.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E MIRATIMIN E DRAFTIT TË RREGULLORES SË LIDHJEVE TË REJA NË RRJETIN E GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 42, pika 3, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, nenit 16, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.8.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Çështjeve Ligjore me nr. 79/12 prot, datë 28.8.2019, për fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e draftit të Rregullores së lidhjeve të reja në rrjetin e gazit natyror,

konstatoi se:

- neni 16, pika 18, i ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, parashikon se, ERE-ja vendos standardet dhe kërkesat minimale për cilësinë e shërbimit dhe furnizimit, veçanërisht për kohën që u duhet operatorëve të transmetimit e të shpërndarjes për të bërë lidhjet dhe riparimet, si dhe mbikëqyr zbatueshmërinë e tyre;

- neni 32, i ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, parashikon se, ERE-ja miraton metodologjinë dhe përcakton tarifat për aksesin në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, tarifat e lidhjes me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes, tarifat për aksesin në hapësirat e depozitimit dhe impiantet e GNL-së dhe tarifat e furnizimit për klientët fundorë që furnizohen në bazë të detyrimit të shërbimit publik;

- neni 42, pika 3, i ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, parashikon gjithashtu se, OST-ja publikon kushtet dhe detyrat e miratuara nga ERE, përfshirë rregullat dhe tarifat për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit. Këto kushte dhe detyrime zbatohen në mënyrë jodiskriminuese për të gjithë klientët;

- neni 53, i ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, parashikon se, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes lidh në rrjetin e shpërndarjes të gjithë klientët, bazuar në kushte jodiskriminuese, transparente, të parashikuara në rregulloret në fuqi, me kusht që sistemi i shpërndarjes të ketë kapacitet të mjaftueshëm dhe të plotësojë të gjitha kushtet e tjera teknike e tregtare;

- neni 54, i ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, parashikon se, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes siguron akses në sistemin e shpërndarjes, brenda kufijve të kapaciteteve të shpërndarjes dhe rregullave teknike, në përputhje me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes, të miratuar nga ERE-ja.

- Ky dokument, i hartuar, mbështetur në sa më sipër, do të përcaktojë procedurën e aplikimit, kriteret për miratimin dhe realizimin e një lidhjeje të re ose modifikimin e një lidhjeje ekzistuese dhe përcaktimin e tarifave përkatëse për lidhjen e pajisjeve të përdoruesit të sistemit me rrjetin e transmetimit ose shpërndarjes së gazit natyror.

- Draft-Rregullorja për lidhjet e reja në rrjetin e gazit natyror është hartuar duke marrë parasysh:

- fazat e hershme të zhvillimit të sektorit të gazit në vend, dhe nevojën thelbësore për zhvillimin e infrastrukturës së gazit, e lidhur kjo me domosdoshmërinë për koordinim midis planeve të zhvillimit të rrjetit dhe lidhjeve të reja;

- nxitjen e investimeve në zhvillimin e infrastrukturës së gazit;

- përvojat e disa vendeve, përfshirë vendet e BE-së, palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë por edhe jashtë rajonit;

- përvojën ekzistuese të grumbulluar në sektorin shqiptar të energjisë elektrike.

Kjo rregullore synon të sigurojë:

- zbatimin e së drejtës së secilit aplikant për t'u lidhur në rrjetin e gazit,
 - tarifa lidhjeje transparente dhe të drejta,
 - zbatimin e sigurt të shërbimeve të lidhjes dhe kosto lidhjeje të drejta,
 - një dokument të thjeshtë dhe praktik, që përshtatet me nivelin aktual të zhvillimit,
 - një numër kërkesash minimale të cilësisë dhe afateve kohore në zbatimin e lidhjeve të reja.
- Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e draftit të “Rregullores së lidhjeve të reja në rrjetin e gazit natyror”.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti